

May 2, 1962

Report on Reiz Malile's Ambassadorial Credentials Sent to the DRV and his Discussions with the DRV Leaders

Citation:

"Report on Reiz Malile's Ambassadorial Credentials Sent to the DRV and his Discussions with the DRV Leaders", May 2, 1962, Wilson Center Digital Archive, AMPJSh V. 1962 D. 231 https://wilson-center-digital-archive.dvincitest.com/document/110162

Summary:

The new ambassador to China and to the DRV, Reiz Malile, reports on his meetings with Vietnamese leaders during his visit to Vietnam on 14 – 28 of April 1962. Malile states that he met DRV President Ho Chi Minh, the Prime Minister of the DRV, Fam Van Dong, Minister of Foreign Affairs for the DRV, Ung Van Khiem, and 1st Secretary of the Central Committee of the Working Party of Vietnam, Le Duan. In his discussions, they support the Albanian government's stance on Khrushchev and the Soviet leadership in general. Meanwhile, the Vietnamese leaders avoid discussions targeted against the Soviet Union and, instead, propose the need for unity in the international communist movement. They also ask to stop the polemic in the media in order for the other bloc not to profit from the internal disputes of the communist camp. According to Malile, among the Vietnamese leadership there is a strong spirit not to cause a break with the Soviet Union. Malile claims that the Vietnamese communists are not fully informed on Albanian-Soviet disputes, which they view as simple disagreements between brothers. According to Malile, there is a great deal of Chinese and Soviet propaganda concerning the political international situation that presents differing points of view.

Original Language:

Albanian

Contents:

Original Scan

Wilson Center Digital Archive Viti: I DEKLASIFIKUAR Dosja# Fleta:)osj∈∦ Vietnas AMBASADA E R.P. TE SHQIPERISE PEKIN Nr. 12ft.sekret. Komitetit Gendror te P.P. Ministrise se P. te Jashteme TIRANE Bashkengjitur ju dergojme nje informacion mbi viziten qe beri Titullari i kesaj Ambasade ne R.D. te Vietnamit me rastin e dorezimit te leter kredencialeve. Relacioni permban te dhenat mbi bisedat a zhvilluara me shoket usheheges vietnameze si dhe njeftime te tjera. he posten e pare do t'ju dergojme edhe dy informacione te tjera plotesuese mbi qendrimin e Titullarit ne Vietnam, nuk patem mundesi t'ia u nisim kete radhe per aresye per arecye se posta diplomatike me shokeve kineze niset shoejt. Ambasadori (Reis Malile) Lidhje: 11 flete.

File u

Viti

losjek

I DEKLASIFIKUAR

MPJ ARKIVI Viti; Dosjak Fleta:

-8-2

Relacion mbi dorezimin e leter kredencialeve nga ena e sh.R.Malile ne R.D.te Vietnamit si dhe mbi bisedet e zhvilluara me kete rast me shoket usheheqes vietnameze

Ne baze te uchezimeve te Ministrise, me 14 prill 1962, shkova ne Hanoi per dorezimin e leter kredencialeve. (Shenoj se udhetimin deri ne Juge te Kines e bera se bashku me trupin diplomatik te akredituar ne Kine, per te cilin Ministrija e puneve te Jashteme te Kines kishte organizuar nje etkursion n'ate zone. Ne daten e siper permendur une shkova ne Vietnam ndersa diplomatet e tjere vazhduan ekskursionin ne zonen veriore).

Ne stacionin hekur-udhor te Hanoit u prita nga ehefi i Protokollit te Ministrise se Puneve te Jashteme,nga Ambasadori i Korese qe eshte dhe duajen i trupit diplomatik,i ngarkuari me pune a.i. i Kines,nje sekretar bullgar,Konsulli pergjitheshem i Indonezise,perfaqusuesi Qeverise Francese dhe perfaqesuesi i Qeverise se Laosit. Titullaret e vendeve te tjera socialiste, per aresyet qe dihen,nuk kishen dale ne pritje. Me pas vetem ambasadori bullgar me kerkoi ndjese qe nuk mundi te vinte ne stacionin e trenit per "aresye se ishte i zene ne nje mbledhie".

Me te zbritur ne stacion shefi i Protokollit me njoftoi se gjate qendrimit ne Vietnam ishem miq te pales se tyre dhe per kete tha "kemi udhezime nga lart". E falenderova per kujdesin e rastit.

Le 16 prill 1952 pera vizite shefit te Protokollit, (15 prill ishte e diel). Ky me njoftoj se leter kredencialet do t'ia dorezoj Zv. Presidentit te Vietnamit shokut Tom Duc Thang mbassi "keshtu ishte praktika e tyre dhe, per larguar dyshimet, me shpjegoj se "shoku Tom Dun Thang eshte shume i njohur ne Vietnamin e Jugut, perpiqemi ti rrisim autoritetin edhe me shume atje. Ai eshte revolucionar i vjeter dhe ka marre pjese ne kryengritjen e flotes se Betit te Zi se bashku me Andre Marti, etj. Natyrisht une nuk ia zgjata.

Po ate dite i bera vizite Ministrit te Jashtem shokut Ung Van Khiem, te cilit i dorezova kopjet e leter kredencialeve si dhe te fjalimit qe do te mbaja.(Lidhur me dorezimin kredencialeve Zv.Presdentit pyeta shoket kines Josjĕ₩

I DEKLASIFIKUAR

MPJ ARKIVI Viti; Dosja№ Fleta:

-2.

ne nje takim mbas dorezimit te kredencialeve dhe me tha, se "ashtu ishte praktikuar edhe here te tjera".

Fjalimin e mbajtur nga ana teme me kete rast,ne e kishem pregatitur shume te ngrohet dhe te forte ne denoncimin e imperializmit amerikan. Fjalimi i tyre ishte shume i shkurter,jo me te njetin tone te ngrehte si toni,veç kesaj karakteristike eshte se nuk kishte asnje fjale kundra imperializmit amerikan qe ka pushtuar gjysmen e Vietnamit.Ne shtypin e tyte, te nesermen e dorezimit te kredencialeve,ata botuan ne faqen e pare nje pjese te fjalimit ku denonciohej imperializmi amerikan nga ana tone,pjesen e fjalimit te tyre ku flitej mbi sukseset e popullit tone nen udheheqien e drejte te Partise se Punes,si dhe nje fotografi nga ceremonija e rastit. Ne te njejten date organi i Partise se Punonjesve te Vietnamit botonte dhe nje artikull me nje fotografi mbi realizimet ekonomike ne vendin tone.

Ne Vietnam qendrova gjithesej dy jave. Gjate kesaj kohe iu bera vizite shokeve qe vijojne: Shokut Ho Shi Min; shokut Le Zhuen, Sekretar i pare i KQPPV; Kryeministrit shokut Fam Van Dong; Zv. Kryeministrit dhe antarit te Byrose politike sh. Lue Zhue Cin, (Delegat i P.P. Vietnamit ne Kongresin e Katert te Partise tone); Presidentit te Asamblese Popullore; Ministrit te Kultures; Ministrit te Arsimit; Ministrit te Tregetise se Jashteme; Ministrit te P. te Jashteme; Kryetarit te Komitetit Ekzekutiv te Qytetit te Hanoit; Zv. Ministrit te Puneve te Jashteme; Zv. Ministrit te Komunikacionit (me kete bisedova mundesite e ardhies ne Haifong te vaporeve tane); Zv. Presidentit te Komitetit per maredhenie kulturale me boten e jashteme, (Presidenti nuk ndodhej ne Hanoi); si dhe disa kryetareve te degeve te Ministrise se Puneve te Jashteme. Gjitashtu iu bera vizitat e rastit kolegeve te trupit diplomatik Po ne kete kohe, per dy dite, shoket vietnameze organizuan nje vizite deri ne qytetet Haifong dhe Hogai, ku vizitova nje miniere qymyri si dhe portin e Haifongut.

Gjate qendrimit ne Hanoi, Ministri i Puneve te jashteme shoku Khiem dha nje darke zyrtare. Veç kesaj kudo qe shkova per vizite u prita nga ana e shokeve drejtuse te qytetit si dhe te qendrave te punes perkatese. Per

Jos je h

I DEKLASIFIKUAR

-3-

MPJ ARKIVI Viti; Josja№ Fleta: 4

bisedimet e zhvilluara ne takimet e siperme si dhe pershtypiet e rastit ne forme permbledhese po shkruajme me poshe.

x

X

x

I.-Wbi bisedimet me shoket udheheges vietnameze:

1.—Shoku Ho Shi kin me priti ne takim me 21 prill 1962,ora 18,45.Ne takim asistonte dhe shefi i Protokollit te Ministrise se Puneve te Jashteme.

Ne fillim e pershendeta shokun Ho Shi Min ne emer të shokut Enver,te shokut Mehmet dhe te udheheqesve te tjere te Partise dhe te popullit tone.Ai u interesua per shendetin e shokut Enver dhe i dhashe pergjegjien e rastit.Me pas me kerkesen e tij e informova shkurter mbi gjendien ne vendin tone mobilizimin e masave punonjese per realizimin e planit dhe arrita ne problemet politike.I thashe se Partija tone çmon sheme perpjekjet e sinqerta te Partise se Punonjesve te Vietnamit per ruajtjen e unitetit.Doja te vazhdoja per ta informuar mbi marredheniet me Bashkimin Sovietik por ai me preu fajlen dhe tha se "kjo eshte detyra tone,nga ana tone ne nuk thomi as kush ka gabim as kush ka te drejte.Tani ne kemi nevoje te domosdoshme per unitetin,na nevoitet medoemos uniteti pse,nga kjo situate,po perfitojne shume armiqte".

Iu pergjogja se Partine tone e preokupon seriozisht kjo gjendie e se ajo ka bere dhe po ben gjithe perpjekjet e duhura per sigurimin e unitetit mbi baza te shendosha.Pas kesaj shoku Ho Shi Min nuk u pergjegj,keshtu qe duke dashur te zgjeroj biseden mbi kete problem i thashe se nuk eshte aspak e drejte qe nje popull e nje Parti besnike deri ne vdekje te marksizem-leninizmit, te Bashkimit Sovietik dhe te gjithe kampit socialist te trajtohen e te sulmohen ne menyre aspak te drejte.Shoku Ho Shi Min nderhyri dhe duke aprovuar besnikerine e popullit shqiptar dhe te Partise tone ndaj kauzes se socializmit tha:"do te bej nje korregjim,nje popull dhe nje Parti jo besnik deri ne vdekje te marksizem-leninizmit por besnike pergjithmone sa te jete jeta"Kjo ishte e gjithe biseda qe beri shoku HoShi Min gjate takimit te siperme.Mendoj se ai nuk desheronte te zgjerohej mbi kete problem prandaj dhe evitoj zgjerimin e bisedes.Takimi gjithsej zgjati 13-15 minuta.Pas kesaj ai

Josje ₩

I DEKLASIFIKUAR

-4-

MPJ ARKIVI Viti; Dosjak Fleta:

At

u ngrit dhe me ftoj te kalojme ne nje salle tjeter per te pare se bashku me te nje film.Ne sallen ku do te çfaqej filmi veç shokut Ho Shi Min dhe mua mernin pjese personoli teknik i pallatit presidencial,njerzit e sigurimit se bashku me familjet dhe femijet e tyre,etj.Aty,ne fillim,nga ana e dy artisteve vietnameze u kendua nje kenge shqipetare e nje vendese pastaj filloj filmi artistik vietnamez.Gjate gjithe kohes shoku Ho Shi Min u tregua mjaft i ngrohet.Ne fund ai kerkoi qe ti transmetoj shume te fala shokut Enver dhe shokeve te tjere drejtuse.(Lidhur me filmin me pas mesova se shoku Ho Shi Min çdo te shtune mbrema shikon filma se bashku me personelim teknik te pallatit presidencial,dhe se ne keto çfaqie,me radhe ai fton edhe perfaqesuesit-titullaret-e vendeve mike se bashku me familjet e tyre, simbas rasteve.Ne sallen ku çfaqej filmi atmosfera ishte shume familjare,nje pjese e pjesemarresve qe nuk kishen arritur te gjenin vend ne karrike ishen ulum ne toke kemb kryq).

2.—Sekretari i pare i Komitetit Qendror te Partise se Punonjesve te Vietnamit shoku Le Zhuen me priti ne takim, me 20 prill 1962, me ngohtesi jashtezakonisht te madhe e miqesore. Ai u interesua shume mbi gjendien ne Shqiperi sidomos per anen ekonomike. I fola hollesiht, po keshtu e vura ne dijeni mbi marredheniet e Partise dhe te Vendit tone me PKBS dhe Bashkimin Sovietik. Gjate gjithe kohes qe flisja une ai degjante me interesim te math dhe tundete koken ne shenje aprovimi per te gjitha qendrimet e Partise tone. Mbassi me degjoj, shoku Le Zhen me tha sa vijon: "Problemin ne teresi, te mosmarreveshjeve, une e di mire pse kam marre vete pjese ne konferencen e Bukureshtit. Neve, vazhdoi ai, kemi ndjekur dhe ndjekim me simpati te thelle e sinqerisht rrugen e lavdishme te popullit shqiptar e te Partise se Punes. Zemrat tona rrahin njelloj, nuk ka asgje qe te ndaje Partine dhe popullin tone nga Partija dhe populli tuaj".

Duke folur per veprimtarine e PP Vietnamit ne drejtim te ruajtjes se unitetit te kampit socialist shoku Le Zhuen tha: "Perpjekjet tona synojne te sigurojme unitetin pse nga kjo gjendie armiqte kane perfituar shume. Tani ka ardhur koha qe Partija Komuniste e Bashkimit Sovietik, Partija Komuniste e Kines, Partija e Punes e Shqiperise, Partija e Punonjesve te Vietnamit dhe te gjitha partite te bejne perpjeje per te deke nga kjo situate dhe per te ndrequr gjendien. Natyrisht kjo do kohe dhe durim, ne radhe te pare duhet te

Jos ič ₩

I DEKLASIFIKUAR

-5-

MPJ ARKIVI Viti; Dosjak Fleta: 6

krijohen konditat pozitive. Tani ka disa shenja permiresimi dhe vete sovietiket ne bisedimet qe kemi pasur me'ta dhe ne letren qe na kane derguar ata shprehin nje deshire te tille". Me pas shoku Le Zhuen me foli shkurt mbi gjendien ne Vietnamin e Jugut, tha se gjendia atje paraqitet e mire dhe se luften "do ta vazhdojme me vendosmeri dhe deri ne fund" Ai falenderoj nxehtesisht Partine dhe popullin tone per mbeshtetien dhe perkrehien pa rezerva te luftes se drejte te popullit vietnamez ne Vietnamin e Jugut.

3.—Po dhe Kryeministri shoku Fam Van Dong me priti shume ngrohet, me
20 prill 1962.Edhe ai u interesua shume mbi gjendien ne Shqiperi politike dhe
ate ekonomike.I fola ne menyre te permbledhur mbi gjendien si dhe unitetin
e çelnikte midis popullit dhe Partise, dhe se sulmeve te Hrushovit popull e
Parti i jane pergjegjur duke forcuar radhet e tyre.Dhe atij i fola shkurt
mbi marredheniet me Bashkimin Sovietik.Shoku Fam Van Dong me tha sa vijon:
"kemi nevoje te domosđoshme per unitetin, pse gjendia eshte keqesuar dhe vetem armiqte kane perfituar.Ne te vertete imperialistet rojne ne baze te dobesive tona, te mungeses se unitetit, per tu permiresuar gjendia duhet durim
dhe durim i math".Ai aprovonte fjalet qe i thosha une mbi qendrimin e drejte
te Partise tone por evitonte te zinte me emer Hrushovin ose çfaqte mendim
lidhur me politiken e PKBS.Me pas ai me foli po ne menyre te permbledhur
mbi gjendien ne Vietnamin e Jugut, tha se atje "lufta vazhdon dhe do te vazhdoje dhe se bazat tona ne Vietnamin e Jugut jane shume te forta".

Shoku Fam Van Dong kerkoj ti transmetoj falenderimet me te nxehta Partise se Punes dhe Qverise tone per perkrahien e madhe dhene luftes ne Vietnamin e Jugut.

Si shokum Le Zhuen ashtu edhe shokum Fam Van Dong ne fillim i pershendeta ne emer te shokut Enver, te shokut Mehmet dhe shokeve te tjere udheheqes. Po keshtu te sipermit ne fund te takimeve me thane shume te fala per shoket tane drejtus. Shenoj se ne bisedimet me ta dhe me gjithe shoket e tjere vietnameze pata kurdohere parasysh udhezimet e Partise dhe biseda teme perqendrohej ne frymen e letres qe Partija tone i dergoj Partise se Vietnamit si dhe ne frymen e artikullit te Zerit Popullit, date 25 mars 1962.

I DEKLASIFIKUAR

MPJ ARKIVI Dosjak

Original Scan

II.-Mbi bisedimet me shoket e tjere vietnameze:

1.-Ministrin e Puneve te Jashteme, shokun Ung Van Khiem, pata rast ta takoj disa here me radhe. Me pergjithesi ai evitonte shume bisedimet mbi mosmarreveshjet me BRSS, bile mund te thomi se ishte nje nder shoket vietnameze qe evitonte me teper se kushdo tjeter bisedat mbi revizionistet. Ne takimin e pare qe pata me te ne fillim biseda ishte e pergjitheshme, mbasandaj une e informova shkurtaz ate mbi zgjerimin e marredhenieve nderkombetare te vendit tone mbas Kongresit te 22 te PKBB dhe me kujdes kalova ku i kane sjelle marredheniet sovietiket me neve.Ai evitonte zgjerimin e bisedes dhe tregohej optimist se gjendia do te permiresohet dhe se si faze e pare duhet te pushojne sulmet ne shtyp nga te dy palet.Ne takimet qe pata me te ne pergjithesi me priti mire dhe me nje korrektese prej diplomati.

2.-Ne takimin qe pata me Zv. Kryeministrin Lue Zhue Cin, Ministrin e Tregetise se Jashteme, ate, te kultumes, Ministrin e ardmit, Presidentin e Asamblese Popullore dhe gjithe shoket e tjere vietnameze, me pritnin shume mire, menjeher me shprehnin simpatine e madhe dhe dashurine per pullin dhe Partine tone, degionin me vemendje shume te madhe gjithçka une iu thosha, aprovonin me nje tundje koke ose me nje"po"qendrimet e Partise tone lidhur me marredheniet me PKBS, por vete nuk shpreheshin. Dukej kjarte se te gjithe sa takova ishen te porositur mbi biseden qe do te benin me mua pse 🕸 gothuajse te gjithe te njejtat fjale thoshin: E fillonin nga korri i ushtrise tone qe kishte lene pershtypie shume te mbedha ne Vietnam, flisnin me simpati te madhe per popullin e Partine tone, nenvizonin nevojen e unitetit, falenderonin per perkrahien luftes se tyre ne Vietnamin e Jugut, etj. Emrin e Hrushevit shume rralle e zinin me goje. Ministri i Tregetise se jashteme me tha: "neve mendojme njelloj, asgje nuk na luan nga rruga tone e perbashket, le te thone cte duan te tjeret, ne imperialistet i kemi te dera dhe do leftojme me vendosmeri kundra tij".

Per te kuptuar me mire gjendien, gjate qendrimit ne Vietnam, si une ashtu edhe shoku Xhafer Bakllamaja, biseduam edhe me njerez te thjeshte, jo vetem kuadro te larta. Kudo dhe cilin do qe takuam u shpreh shume mire per Partine tone dhe Shqiperine si anetar i denje e kampit socialist. Me poshte japim disa Josje Fle I DEKLASIFIKUAR

MPJ ARKIVI Viti; Dosja‰ Fleta: Original Scan

shembuj konkret: Zv. Drejtori i nje instituti te larte arsimor i foli hapet sh. Xh. Bakllamaja kunder politikes se Hrushovit, (per kete te shihet informacioni i veçante)/. Zv. Drejtori i portit te Haifongut me tha se "shume drejte ka venruar Partija tuaj kundrejt politikes se Hruashovit, edhe ne po te ishim ne vendin tuaj po ashtu do te vepronim".

Shoferi i automobilit qe na kishen vene ne dispozicion, i cili duhej te ishte kuader i sigurimit pse kishte mjaft zhvillim, kish marre pjese ne kurse partije dhe dhe partizan per nende vjet me radhe, mbassi i folem per revizionizmin tha Neve problemi ne Parti nuk na eshte skjaruar gjeresisht, masa e Partise ceshtien akoma nuk e ka mire te kjarte, udheheqia i di mire gjithe problemet por neve jo.Ne Parti na eshte thene shkurt se cka ndodhi ne Kongresin e 22 jane mos-marreveshje midis vellezerve dhe qe do te zgjidhen, pyetje nuk jane lejuar. Une, vazhdoi i sipermi, fjalimin e shokut Enver e kam degjuar te transmetuar nga radio Saigoni". Pastajme revoltim shtoj" une jam dakord me shokun Enver, keshtu jane dhe gjithe komunistet e tjere dhe njerzit e thjeshte. Edhe sikur te kete gabim nuk mund te trajtohet keshtu vellaj i vogel, duke e vrare me gjithse nuk ka faj". Edhe per ndihmat qe Bashkimi Sovietik i jente Naserit, Nehruit, Sukarnos, etj. fliste me revoltim: "iu jep atyre tha, kurse ne ketu pas kaq vjetesh lufte dhe sakrifica jemi ne gjendie akoma shume te varfer. Ne marrim vetem nje kostum te lehte, dok, ne vit, dhe per te blere nje biçiklete na duhet te kursejme tre vjet me radhe".Problemi i ndihmes dukes te ishte diskutuar dhe me te tjete, ne kate drejtim çfaqej nje pakenaqesi e pergjitheshme. Pati raste qe dhe shoke te tjore vietnameze ma permenden; duke thene se ekonomikisht nuk jemi mire ata shtonin se kjo gjendie veshtiresohet pse tani duhet te çlyejme brenda nje permudhe te shkurter dhe borxhet, d.m. th. ato ge i kane Bashkimit Sovietik.

Eshte karakteristike te shenohet se edhe me njers te thjeshte te takuam ne qendra pune ose edhe rstesisht ne nje park, te gjithe flisnin shume mire dhe me simpati per Shqiperine, por pergjithesisht per divergjencat ne levizjen komuniste nderkombetare dhe per karakterin e tyre ishen shume pak te informuar. E vetmia pike qe ata flisnin hapet dhe pa rezerva ishte lufta kundra imperializmit amerikan.

Jos ja №

I DEKLASIFIKUAR

....

15

-8-

Viti; Dosjak Fleta

III.-Disa konklusione:

1.—Ne pergjithesi masa e Partise dhe populli vietnamez, me gjithe sulmet ne Kongresin e 22 te PKBS, vazhdon te kete nje mendim shume te drejte mbi Partine e Punes dhe vendin tone. Ne ditet qe zhvillonte punimet Kongresi i 22, ne Parti e ne popull pati nje fare diziluzioni, kjo per faktin se ato nuk dinin gje me pare se ç'po ngjiste ne levizjen komuniste nderkombetare. Ne ato dite Radio Moska transmetonte ne gjuhen vietnameze sulmet e Hrushovit kundra Partise dhe vendit tone, por fill mbas kesaj, fillonte Radio Pekini e cila transmetonte meteriale, po ne gjuhen vietnameze, tjeter per tjeter nga ato te transmeturra nga Radio Moska. Megjithe situaten e rende, prape Partija nuk beri skjarime te gjera por, u kufizua ne shpjegime te thjeshta. Persa i perket kuadrove duket se skjarimet u bene menjehere, ne fryman e pajtimit dhe te ruajtjes se unitetit".

Me pas e verteta, ne menyre te hollesishme u mesua nga gazeta "Zhen Min Zhi Bao", me fjalimin e shokut Enver si dhe me materialet e tjera te Partise tone. Po keshtu nga materialet qe dergoj, ne shumice, Ambasada tone si dhe nga ato te shperndara nga ana e Ambasades kineze ne Hanoi. Shoket kineze me thane se, ne ato dite, nje numur t math personash u drejtua ne Ambasadeb e tyre per te marre materiale nga tonat ose huanin "Zhe Min Zhi Baon". Nga materialet tona shoket vietnameze ne shtyptn e tyre nuk botuan as-gje. Fjalimi i shokut Enver dhe artikujt e tjere te "Zeri i Popullit", nge se mesuam, jane perkthyer ne gjuhen vietnameze dhe iu jane dhene per lexim ve tem kuadrove. Kjo pune eshte bere ne seket, pothuajse te plote, dhe qe kopjet e shaptilografuara te mos binin ne dore te mases ose te sovietikeve. I ngarkuari me pune a.i. kinez e mesoj vetem nga une faktin qe fjalimi i shokut Enver ehte perkthyer e shoerndare kuadrove per lexim, te pakten keshtu me tha.

Per botimin e fjalimit te shokut Enver ne gjuhen vietnameze na tha nje student toni, i cili e kishte pare vete, ia kish treguar ne konfidence nje kuader vietnamez. Po keshtu me tha zv. kryetari i Komitetit per marredhenie kulturale si dhe zv. kryetari deges shtypit te Ministrise se Jashteme. Sh. Xh/Bakllmaja i tha nje zv. drejtor i nje instituti te larte arsimor.

File

IS je #

1 DEKLASIFIKUAR

Original Scan

MPJ ARKIVI Viti; Dosjam Fleta

2.-Nga konstatimet qe patem gjete qendrimit ne Vietnam, duket kjarte se ne esence Partija e Punonjesve te Vietnamit nuk aprovon ne asnje menyre sulmet e drejtuara nga Kongresi i 22 kunder Partise tone, dhe se ajo kupton mire demin e math qe po i sjellin revizionistet levizjes komuniste e punetore ne teresi. Kjo duket dhe ne faktin se marredheniet e RD Vietnamit me Bashkimin Sovietik nuk jane me fazen e mepareshme, tani ato jane ftohur. Me gjithe kete, atje egziston akoma e forte "fryma e pajtimit dhe uniteti me çdo kusht", pa peshuar mire se mbi çbaze duhet te sigurohet ky unitet, kjo nuk mund te thuhet se egziston ne te gjitha kuadrot.

-Qendrimi i Partise se Punonjesve te Vietnamit kundrejt divergjencave ne teresi, ka influencuar edhe ne zhvillimin ne nje shkalle me te ulet te marredhenieve shteterore midis Viotnamit dhe Bashkimit Sovietk. Ne gjithe bisedimet shoket vietnameze evitonin absolutisht te flitnin mbi marredheniet e tyre me Bashkimin Sovietkk. Egziston nje fryme e forte "te mos prishemi me Bashkimin Sovietik", "te mos keq-kuptohemi nga ta". Ne bisedim me kryetarin e deges se vendeve socialiste te Ministrise se Puneve te Jashteme mbi mundesine e hapies se perfaqesive te perhereshme te te dy vendewe reciprokisht ne Tirane e Hanci, ai me tha se prej kohesh ata donin te hapnin ambasaden e tyre ne Tirane por, me qene se ndodhen mos-marreveshjet."nuk vepruam se mos keq-kuptehet nga te tjeret dhe se do ta hapim me tu normalizuar gjendia". Une i thashe te sipermit se nuk ka rendesi "puna edhe keshtu behet.megjithate c'pune kane ketu te tjeret juve jeni shtet indipendent dhe nuk pyesni njeri se ku do hapni ose jo perfaqesi". I sinermi e pa qe e shkeli, me tha nje sekret te tyre, dhe nuk e zgjati. Shenoj se shoku Ho Shi Min po per kete çeshtie me tha se "ne jemi shtete te vegjel dhe nuk perballojme dot shpenzimet e shumta te perfaqesive"; une nuk i thashe asnje fjale.

Po ne kete kuader -kompromisi-,"te mos keq kuptohemi", mund te shpjegohet edhe fakti qe mua nuk me priti Presidenti me rastin e dorezimit te
kredencialeve por Zv.Presidenti, pde ne fund te fundit "praktika" ne rastin
e maredhenieve midis vendeve miq mund te lihej me njane.Po keshtu ne kete
kuader mund te shpjegojme edhe qendrimin e tyre qe nga njera ane me presin
shume ngrohet nga ana tjeter fjalimi i Zv.Presidentit, qe do botohej publikaht
nuk i pergjigjej

I DEKLASIFIKUAR

]osjē∦

-10-

MPJ ARKIVI

Dosja№

Fleta:

ngrohtesise se fjalimit tone. Eshte per te shenuar se edhe persa i perket takimevet me shoket udheheqes vietnameze, ata ne shtypin e tyre botuan vetem lajmin qe mx UAmbasadori i Shqiperise u prit ne takim"nga shoku Ho Shi Min,etj por frzen e fundit, qe zakonisht botohet ne te tila raste, (takimi kaloj ne nje atmosfere te perzemert migesore").nuk e botuan.

Nga takimet qe pata me te ngarkuarin me pune te Kines ne Vietnam,kam perchtypien, se ai pak ishte ne dijeni te gjendies ne Vietnam, dhe kjo ndoshta per faktin e "mos keq-kuptimit".P.sh.megjithse kishen kaluar me se gjashte muaj nga Kongresi 22 i PKBS ai akoma nuk dime ne se ishte botuar ne gjuhen vietnameze fjalimi i shokut Enver dhe materialet e tjara te Partise tone. Gjithashtu ai me tha se akoma "nuk dinte asgje" mbi rezultatin e bisedimewe te delegacionit te Partise Komuniste te Bashkimit Sovietik qe vizitoj disa muaj me pare Vietnamin. Natyrisht ketu influencon ndoshta dhe qendrimi (ose heshtia) i kufizuar i shokeve vietnameze.

4.--Gjate diteve te qendmimit ne Vietnam, u informuam se veprat e Stalinit vazhdojne te studiohen se bashku me ato te klasikeve te tjere, si ne format e arsimit ne Parti ashtu edhe ne institucionet arsimore.Ne pergjithesi masa nuk aprovonte sulmet e Hrushovit kundrejt Stalinit dhe ne menyre te posaçme nuk aprovonte heqien e trupit te tij nga mauzeleumi.

> I I

Shenojme se para se te mbrinim ne Hanoi, ishem interesuar te zinim vend ne hotel, te mos zinim vile si heret e tjera pse kjo kushtonte shume. Por shoket vietnameze me te mbritur na vune ne dijeni se gjate qendrimit ne Vietnam si une dhe sh. Xh. Bakllamaja ishem miq te tyre, se no ishte rezervuar nje vile. Vila ishte nje nder me te mirat dhe nga sa u informuam perdorej vetem per delegacione te remdesishme. Ushqimi ishte special po keshtu edhe pijet e ndryshme.Ne dispozicion na u vune gjithashtu edhe dy vetura:nje Zim nje Pobiede. Dy perkthyes qendronin vazhdimisht me ne. Cdo dite Ministrija e Jashteme intereschej ne se kishem nevoja. U informuam se me personelin teknik qe na sherbente ishte bere mbledhie e veçante per te na sherbyer sa me mire. Ne kete drejtim kujdesi the mike-pritja e shokeve vietnameze, kete radhe ka qene shume e mire.

Josjak Fl

I DEKLASIFIKUAD

MPJ ARKIVI Viti; Dosjak Flet 12

-11-

Lidhur me sa me siper, mendejme se edhe Ambasadori i Vietnamit, ne rastin me te pare qe de te vije ne Tirane te jete mik i pales tone per ditet qe do te qendroje aty.

Persa shkruajme ne kete relacion ne rast se keni ndo nje vrejtje ose udhezim, lutemi na njoftoni.

Ambasadori (Reis Malile)

Pekin 2 maj 1962